



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 22.1.1-2014-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË MITROVICËS**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014**

**Prishtinë, Qershor 2015**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Mitrovicës në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit Florim Beqiri i mbështetur nga Lavdim Maxhuni (Udhëheqës Ekipi), Mexhit Ferati dhe Cyme Hoxhaj.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	8
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	10
3 Rekomandimet e vitit paraprak .....	14
4 Qeverisja .....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	31
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak .....	34


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Mitrovicës për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i PVF për vitin 2014 u ndërмор në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me PVF. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 01/10/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë t'ju tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se shpalosja e Pasurive Fikse ende nuk është i plotë dhe i saktë, për arsye se janë identifikuarë prona komunale si: toka, lokale, banesa që nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk ishin prezantuar në PVF. Sipas SNKSP të bazës së parasë së gatshme, shpalosja e pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale').


**(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**


### Konkluzioni i përgjithshëm


Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrolle nuk kishin funksionuar në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar. Këto duhet në vazhdimësi të monitorohen për t'u siguruar se janë duke funksionuar siç duhet. Ne në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësi:

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:







### **Përgjigja nga Menaxhmenti - auditimi për 2014**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

Ne e marrim si punë të kryer që Kryetari :

- Të diskutoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit Janar/shkurt 2016 të inicioj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e financave

# 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës së Mitrovicës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Vjetore Financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehim mendimin:

- nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin tonë të auditimit të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të rezultateve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë, nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e ndërmjetme të auditimit, ne ofruam këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.



Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

## 2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i Komunës (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm lidhur me PVF-të është se janë identifikuar gabime tek shpalosjet në kode ekonomike dhe tek pasuritë, ndërsa sa i përket kërkesave të raportimit, ato ishin plotësuar.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

#### Theksimi i çështjes

Dëshirojmë t'ju tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se shpalosja e Pasurive Fikse ende nuk është i plotë dhe i saktë, për arsye se janë identifikuarë prona komunale si: toka, lokale, banesa që nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk ishin prezantuar në PVF. Sipas SNKSP të bazës së parasë së gatshme, shpalosja e pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale').

**(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

## 2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 01/10/2014, janë identifikuar tri rreziqe domethënëse: atë për regjistrimin e të gjitha pasurive që kanë ndikim në PVF-të, pagesat nga palët e treta si dhe keq klasifikimin e shpenzimeve në kode adekuate.

Këto janë rreziqe të anomalive materiale të cilat mund të rezultojnë me modifikim të opinionit.

Rreziqet e anomalive materiale që ne i kemi identifikuar në lidhje me regjistrimin dhe prezantimin e pasurive, si dhe keq klasifikimin e shpenzimeve në PVF-të kanë ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rreziqet e paraqitura.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate

##### Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne kemi testuar nëse komuna i kishte klasifikuar drejt shpenzimet e bëra nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale dhe kemi ardhur në përfundim se edhe në këtë vit ka pasur raste të keq klasifikimit të shpenzimeve, cilat kanë të bëjnë më kontrata e trashëguara nga viti i kaluar. Nga kategoria investime kapitale ishin paguar 132,288€ për mallra dhe shërbime.

**Rekomandimi 1 Prioriteti i lartë** – Për të evituar keq pohimin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarr të gjitha veprimet që shpenzimi i buxhetit dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas ndarjeve buxhetore dhe sipas kodeve ekonomike adekuate.

### Rreziku i identifikuar

#### Çështja 2 - Mungesa e regjistrimit të pasurive që janë në pronësi të komunës

Ne kemi identifikuar se komuna ka probleme me regjistrimin e pasurive të saj, dhe kjo mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në PVF.

##### Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta konfirmuar nëse të gjitha pasuritë që janë në pronësi të komunës janë regjistruar në regjistrat përkatës. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e saktë. Menaxhmenti kishte ndërmarrë disa masa dhe ka aplikuar kontrolle për pasuritë mbi 1,000€, ku çdo pagesë që është bërë dhe i plotëson kushtet për t'u regjistruar si pasuri, ishte regjistruar në regjistrin kontabël të pasurive, mirëpo ende e gjithë pasuria e komunës nuk është regjistruar si: banesat, lokalet dhe pronat. Sistemi e-pasuria nuk ka

funksionuar dhe nuk na është ofruare ndonjë raport nga ky sistem. Komuna posedon një regjistër për pasuritë nën 1,000€ në formë të Excel. Komuna kishte formuar komisionin për inventarizim dhe ky komision kishte përgatitur raporte mbi gjendjen e pasurisë. Më tutje, mbetet sfida që të vendosë kontrollë shtesë në mënyrë që të gjitha pasuritë të regjistrohen në regjistrat e nevojshëm dhe pastaj të bëhet një prezantim i drejtë në PVF.

**Rekomandimi 2 Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të siguroj vazhdimin e procesit të regjistrimit të të gjitha pasurive, ku rol kyç në këtë proces duhet të ketë Drejtoria e Kadastrit, duke siguruar/ofruar të gjitha të dhënat mbi pronat publike në posedim të komunës. Më pas, ne do të sugjeronim që një komision i veçantë duhet të bëjë një vlerësim dhe një raport t'ia dorëzoj zyrtarit të pasurive për t'i proceduar regjistrimet e duhura në sistemin e SIMFK (moduli i pasurive). Të funksionalizoj përdorimin e modulit E-pasuria për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e të gjitha pasurive. Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen para se PVF-të e vitit 2015 të jenë dorëzuar.

### **Çështja 3-Prezantimi i pagesave nga palët e treta në PVF-të**

Ne gjatë auditimit kemi vërejtur se komuna i ka shpalosur drejtë pagesat e palëve të treta dhe në këtë mënyrë prezantimi që është bërë në PVF është i saktë dhe i drejtë.

## 2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

### Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ajo kishte përmbushur kërkesat raportuese si në vijim:

- Pajtueshmërinë me RrF. nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF-të janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- PVF-të janë nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- PVF-të janë dorëzuar në gjuhën shqipe;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë; dhe
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

PVF-të ishin përgatitur në pajtim me kërkesat e rregullores financiare 03/2013, me përjashtim të çështjeve të ngritura më poshtë:

---

### Çështja 4 - Procesi i përgatitjes së Pasqyrave - Prioriteti i lartë

<b>E gjetura</b>	<p>Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve. Nga fondet e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 132,288€. Këto keq klasifikime kanë ndodhur për shkak të kontratave të trashëguara nga viti 2013.</p> <p>Duke u bazuar në regjistrin që kemi siguruar në Drejtorinë e urbanizimit për pronat e dhëna më qira, aty janë identifikuar toka, banesa dhe lokale që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të pasurive.</p>
<b>Rreziku</b>	<p>PVF përveç mos shpalosjes së plotë të pasurive dhe klasifikimit të gabuar të shpenzimeve në kodet ekonomike, janë në pajtim me standardet dhe rregullën financiare nr. 03/2013.</p>
<b>Rekomandimi 3</b>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF të vitit 2015 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat e që kanë të bëjnë me cilësinë e informatave. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar nuk duhet të dorëzohet para se të jetë kryer një rishikim final nga ana e menaxhmentit në draft PVF.</p>

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

#### Konkluzioni i përgjithshëm

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2013 ka rezultuar me 24 rekomandime kryesore. Menaxhmenti i komunës kishte përgaditur planin për adresimin e rekomandimeve tona dhe me një kujdes të shtuar kishte trajtuar rekomandimet e dhëna në vitin e kaluar. Ne vlerësojmë angazhimin e bërë, por menaxhmenti ende ka nevojë të forcoj procesin e llogaridhënies së menaxherëve në zbatimin e rekomandimeve, secili në fushat përkatëse ku janë identifikuar dobësitë e kontrolleve.

#### Përshkrimi

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, tetë (8) rekomandime janë adresuar plotësisht; njëmbëdhjetë (11) janë adresuar pjesërisht, dhe pesë (5) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

---

#### Çështja 5- Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** Vetëm një e treta e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse menaxhmenti i komunës nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP. Nuk është e qartë nëse menaxhmenti e kupton mjaftueshëm rëndësinë e çështjeve të ngritura nga auditimi.

**Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, si: ekzekutimi i buxhetit, ndarja e tenderëve, mosrespektimi i kriterëve në dosjet e tenderëve, dhënia e subvencioneve dhe keq klasifikimi i vazhdueshëm i shpenzimeve, kanë rezultuar në jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ, vlerë të dobët për para në praktikat e prokurimit, keq pohim të shpenzimeve dhe menaxhim të dobët me pasuritë.

**Rekomandimi 4** Kryetari duhet të inicojë një analizë të shkaqeve dhe arsyeve që qëndrojnë prapa rekomandimeve të pa adresuara të auditimit. Një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të këtij raporti dhe rekomandimeve të mëhershme duhet të hartohet deri më 31 korrik 2015, dhe të përcaktoj të gjitha veprimet, stafin përgjegjës dhe një kornizë kohore brenda së cilës plani do të implementohet. Ne sugjerojmë një monitorim direkt të këtij procesi nga ana e Kryetarit.

## 4 Qeverisja

### Konkluzioni i përgjithshëm

Procedurat e një qeverisjeje të fortë kërkojnë që si aktivitetet strategjike ashtu edhe ato operacionale të zbatohen dhe monitorohen në mënyrë efektive. Ne kemi vlerësuar disa aktivitete që kemi vlerësuar se kanë kontribuar në një qeverisje të mirë, po ashtu për të përcaktuar nëse ekzistojnë mundësitë për përmirësim të mëtejshëm.

Vlen të theksohet se në aspektin e menaxhimit nëse e krahasojë me vitin e kaluar komuna kishte bërë progres në disa fusha siç janë përgatitja e PVF-të, Të hyrat, Menaxhimi i pasurisë, mirëpo edhe më tutje duhet të angazhohet për një menaxhim më efikas dhe efektiv.

Aspektet kyçe të qeverisjes janë adresuar nga Komuna e Mitrovicës si në vazhdim:

- Vetëvlerësimi – Komuna kishte përpiluar vetëvlerësimin dhe kishte dorëzuar një raport të tillë në MF, edhe pse në të ardhmen komuna duhet të jetë më kritike ndaj vlerësimit të rezultateve të arritura;
- Menaxhimi i rrezikut – Komuna ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve me financat dhe rezultatet;
- Mungesa e raportimit të formalizuar të menaxhimentit; dhe
- Auditimi i brendshëm në 2014 ka marrë në konsideratë kryesisht aktivitetet e vitit 2013 dhe si rrjedhim nuk e ka mbështetur menaxhimentin në vlerësimin e efektivitetit të gjithë sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin vijues.

Si të tilla, aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes kërkojnë forcim. Po ashtu kemi identifikuar që kontrollet mbi të hyrat dhe kontrollet mbi një numër të fushave të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar humbjen financiare të komunës, vlerën e ulët për para dhe menaxhimin jo efektiv të projekteve kapitale. Fushat kryesore që kanë nevojë për përmirësim janë; të hyrat, prokurimi, subvencionet, ekzekutimi i buxhetit.

## 4.1 Qeverisja e mirë

### Përshkrim

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja 6 – Proceset e llogaridhënies – Prioriteti i lartë

**E gjetura** Pas rishikimit të kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës për vitin 2014, kanë rezultuar dobësi evidente në raportim. Raportimit tek kryetari bëhet sipas nevojës dhe nuk ka raportime me shkrim prej drejtorëve në baza të rregullta për punët dhe aktivitet e tyre. Pasi që e kemi ngritur këtë çështje edhe në memon tonë nëntë mujore. Menaxhmenti kishte filluar ta implementoj këshillën tonë. Raportimi tani bëhet në baza javore me shkrim prej drejtorive. Ne nuk jemi mbështetur në funksionimin e kontrolleve të nivelit të lartë tek disa kategori ekonomike, si: të hyrat, mallrat dhe shërbimet, subvencione dhe transfere, investime kapitale.

Mos zhvillimi i aranzhimeve të komunikimit efektiv në komunë ka rezultuar në koordinim të varfër dhe aranzhime të dobëta të kontrolleve në fushat si prokurimi, subvencionet si dhe të hyrat nga dhënia në shfrytëzim të pronës komunale; dhe

Kërkesat për të aplikuar vetëvlerësim dhe regjistra të rrezikut janë adresuar vetëm pjesërisht pasi rëndësia e këtyre si mjete për ta mbështetur menaxhimin efektiv nuk është identifikuar plotësisht. Nuk ka të vendosur regjistër formal të rrezikut apo proces të menaxhimit të rrezikut, i cili do t'i identifikonte qartë rreziqet në arritjen e objektivave operative si dhe zvogëlimin e tyre.

**Rreziku** Kërkesat e dobëta për qeverisje/llogaridhënie dhe raportimi i cilësisë së dobët, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit operativ dhe financiar brenda OB-së dhe mund të rezultojnë me humbje financiare.

**Rekomandimi 5** Kryetari duhet të iniciojë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të qeverisjes/llogaridhënies dhe të kërkesave të raportimit. Kërkesat e pazbatuara duhet të zbatohen deri në fund të vitit 2015. Cilësia dhe përmbajtja e raportimit të brendshëm, duhet të rishikohet në mënyrë kritike për të demonstruar ndryshimet pozitive në menaxhimin operativ dhe arritjen e objektivave strategjike.

---



## 4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për Komunën e Mitrovicës, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>14,625,427</b>	<b>16,505,287</b>	<b>15,051,981</b>	<b>16,398,203</b>	<b>17,718,664</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	12,312,991	13,783,560	13,477,762	14,654,588	15,491,288
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup> -	-	130,407	125,102	235,901	443,509
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	2,312,436	2,312,436	1,391,035	1,239,425	1,387,880
Donacionet e brendshme	-	203,324	45,270	163,331	127,368
Donacionet e jashtme	-	75,560	12,812	104,958	268,619

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 1,879,600€. Kjo rritje është rezultat i vendimit të Qeverisë për rritjen e pagave dhe mëditjeve prej 25% në vlerën prej 1,470,309€, të hyrat e bartura prej 130,407€ si dhe donacioneve të brendshme dhe të jashtme me vlerë 278,884€.

Buxheti final për vitin 2014 ishte ekzekutuar në nivelin 91% të planifikimit

**Tabela 2: Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (€)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>14,625,427</b>	<b>16,505,287</b>	<b>15,051,981</b>	<b>16,398,203</b>	<b>17,718,664</b>
Pagat dhe Mëditjet	8,892,313	10,372,660	10,299,754	8,842,940	9,792,508
Mallrat dhe Shërbimet	1,934,231	2,020,444	1,565,467	1,380,404	1,545,347
Shërbimet komunale	402,740	402,740	344,815	425,406	433,447
Subvencionet dhe Transferet	877,000	881,400	816,527	787,854	773,744
Investimet Kapitale	2,519,143	2,828,043	2,025,418	4,961,599	5,173,618

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual të përdorura për vetëfinancim.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Ndryshimi më i madh ka ndodhur tek kategoria e pagave dhe mëditjeve. Qeveria nga muaji Prill i vitit 2014 ka marrë vendim për ngritjen e pagave për 25% për të gjitha kategoritë në sektorin publik;
- Vetëm 21% e buxhetit për Donacione është shpenzuar. Komuna ka dështuar t'i përdorë donacionet për shkak të pamundësisë për të vendosur kontrolle buxhetore mbi projektet e financuara nga donatorë të brendshëm dhe të jashtëm. Komuna kishte pranuar grante nga donatorët e brendshëm dhe të jashtëm me vlerë 278,884€, ndërsa prej tyre janë shpenzuar vetëm 58,082€;
- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve buxheti ishte shpenzuar rreth 77%, arsyeja pse ka mbeture rreth 23% e mjeteve pa u shpenzuare është se planifikimi i të hyrave që ishte dedikuare për këtë kategori ekonomike nuk ishte realizuar dhe për këtë arsye buxheti nuk ishte e mundur të shpenzohet sipas parashikimeve;
- Te kategoria e investimeve kapitale vërehet rritje e buxhetit për 308,900€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar për 40,000€, dhe granteve të përcaktuara të donatorëve për 268,900€;

---

#### Çështja 7 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

**E gjetura** Ekzekutimit buxhetit ka një rënie nga viti në vit, dhe kjo rënie reflekton edhe reduktimin e aktiviteteve të komunës. Një shkallë tejet e ultë e shpenzimeve vërehet sidomos te shpenzimet kapitale, ku fondet e planifikuara ishin shpenzuar vetëm 72%. Gjithashtu, planifikim i dobët vërehet edhe tek shpenzimet komunale, ku devijimet nga plani ishin 14%, ndërsa fondet e pa shpenzuara për subvencione ishin mbi 7%. Për shkak të menaxhimit të dobët, rreth 80% të donacioneve të jashtme dhe të brendshme, komuna kishte dështuar t'i materializoj në projekte konkrete.

**Rreziku** Dobësitë në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit e zvogëlojnë efektivitetin e planeve të komunës dhe do të rezultojnë në mos arritjen e objektivave të përcaktuara. Niveli aktual i ekzekutimit mund të rezultojë në reduktimin e granteve qeveritare dhe në financimin e obligimeve të vitit aktual nga buxheti i vitit të ardhshëm. Përdorimi në shkallë të ulët i donacioneve mund të rezultojë që donatorët të mos ofrojnë donacione në vitet e ardhshme. Mos përdorimi i të hyrave vetjake mund të rezultojë në ngecje të realizimit të projekteve të financuara nga ky burim.

**Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurojë monitorim më të mirë dhe sistematik të performancës buxhetore dhe në baza mujore, T'i identifikoj dhe adresoj pengesat në përmirësimin e nivelit të ekzekutimit të buxhetit dhe në përdorimin efektiv të të hyrave vetjake dhe donacioneve. Nëse supozimet fillestare buxhetore janë të pasakta, kjo duhet të rishikohet në pozitën e buxhetit final. Për më tepër duhet të adresohen arsyet që qëndrojnë prapa mospërputhjeve midis planifikimit dhe shpenzimeve aktuale.

### Çështja 8 - Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe nenit 39.2 LMFFP - Prioritet i lartë

**E gjetura** Për shkak të kontrolleve të dobëta dhe neglizhencës në pagesën e obligimeve sipas vendimeve gjyqësore janë ekzekutuar pagesa direkte me vlerë prej 5,517€. Në të njëjtën kohë, 60,388€ janë ekzekutuar sipas nenit 39.2 të LMFFP

**Rreziku** Shumat e ekzekutuara të pagesave në bazë të vendimeve gjyqësore ndikojnë në prishjen e bilancit buxhetor dhe rrisin rrezikun që projektet e planifikuara të mos realizohen.

**Rekomandimi 7** Kryetari duhet të siguroj forcimin e disiplinës financiare për kryerjen e pagesave me kohë si dhe do t'i rishikoj të gjitha obligimet e mbetura në mënyrë që të minimizojë tërheqjet bazuar në vendimet gjyqësore.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2014 (në euro)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimi	2013 Pranimi	2012 Pranimi
Të hyrat vetjake	2,312,436	2,312,436	1,645,625	1,368,877	1,700,028

Siç shihet nga tabela, të hyrat e planifikuara për vitin 2014, janë 2,312,436€. Realizimi është 1,645,625€ apo 71%, duke përfshirë edhe gjobat e gjykatave dhe dënimet e policisë. Ky nivel i inkasimit të hyrave është mjaft i ulët. Nëse bëjmë një krahasim në raport me vitin e kaluar shihet një ngritje e të hyrave për 276,748€, por krahasuar me dy vite më parë kemi një rënie prej 54,403€. Ngritja e të hyrave më e theksuar është tek tatimi në pronë dhe taksat për regjistrimin e automjeteve.

Ngecje e theksuar e të hyrave vërehet tek drejtoria e urbanizimit. Prej 1,114,000€ të planifikuara, ishin mbledhur vetëm 297,468€, apo 27%. Drejtoria e shëndetësisë kishte planifikuar shumën prej 120,000€, ndërsa nga kjo shumë kishte realizuar vetëm 54,919€. Arsyeja pse është inkasuar një shumë kaq e ultë, sipas zyrtarit përgjegjës është se fillimisht planifikimi i të hyrave tek këto drejtori ka qenë më i lartë se sa parametrat real. Variancat në mes shumave të planifikuara dhe të realizuara në këto dy drejtori janë të mëdha dhe determinojnë një efikasitet të ultë.

## 4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

### Përshkrimi

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Mitrovicës në vitin 2014 ishin në total 1,645,625€. Zërat kryesor që përbëjnë shumat e mbledhura janë: Të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksa për regjistrimin e automjeteve, të hyrat nga lejet e ndërtimit, etj.

---

### Çështja 9 - Të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale - Prioritet i lartë

**E gjetura** Për pronat e dhëna me qira, komuna kishte planifikuar që të realizoj 180,000€, ndërsa kishte arrit të realizoj 108,216€, apo 60% e planifikimit.

Komuna kishte ndërmarrë masa ndaj shfrytëzuesve të pronës komunale duke ju dërguar shkresa për t'i kryer obligimet dhe kjo deri në një masë ka pasur efekte, megjithatë përqindja e inkasimeve mbetet shumë e ultë.

Ne kemi marrë nga drejtorja e urbanizimit një regjistër në formë të Excel-it për qiramarrësit që e shfrytëzojnë pronën komunal. Nga mostrat e testuara për pronat e dhëna me qira, kemi vërejtur se në një rast mungonte kontrata për qiradhënie për vitin 2014. Po ashtu, në tri raste obliguesit nuk i kishin kryer obligimet e tyre ndaj komunës për pronën që shfrytëzojnë. Obligimi i tyre ndaj komunës ishte 6,108€.

Sipas regjistrit të drejtorisë se urbanizimit figurojnë 14 banesa për të cilat komuna kishte lidhur kontrata për dhënien me qira me qiramarrës të ndryshëm në vitin 2009 deri 2011. Qiraja mujore për këto banesa ishte 17.66€. Këta qiramarrës nuk kishin paguar asnjëherë borxhin ndaj komunës, edhe pse vazhdojnë t'i shfrytëzojnë këto banesa.

Drejtorja e urbanizimit në vitin 2011 kishte lidhur kontratë me shfrytëzuesin "NSH. Klinika Dentare Shkodrani" për dhënien me qira mujore të dy lokaleve afariste në vlerë prej 289€. Kontrata përcakton se lokali do të meremetohet nga shfrytëzuesi dhe qiramarrësi kishte sjellë një plan ideor se në këto lokale do investoj rreth 19,489€. Me datën 12.12.2014, komuna kishte formuar një komision profesional për vlerësimin e investimeve të bëra në lokalet afariste që i shfrytëzon qiramarrësi. Ky komision nuk e kishte kryer punën. Ndërsa deri më tani, shfrytëzuesi nuk kishte paguar asnjëherë ndaj komunës qiranë mujore.

### Rreziku

Përkundër masave dhe veprimeve nga ana e menaxhmenti që qiramarrësit t'i kryejnë obligimet e tyre sipas kontratave, në përgjithësi realizimi i të hyrave nga kjo kategori në raport me planin mbetet i ultë. Vazhdimi i praktikave të tilla janë precedan i keq që mund të nxisin edhe obliguesit tjerë t'i shmangen pagesës së qirave. Mos realizimi i të hyrave të planifikuara rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetjake.

---

**Rekomandimi 8** Kryetari duhet të inicojë rishikimin e të gjitha kontratave ekzistuese për dhënien me qira të tokës, lokaleve dhe banesave dhe të identifikoj arsyet e mos pagesës se obligimeve. Masat të cilat përcaktojnë afatet kohore dhe përgjegjësit duhet të propozohet brenda një afati të arsyeshëm dhe të bëhet një raportim mbi progresin tek menaxhmenti i komunës të paktën çdo tre muaj.

#### Çështja 10 - Tatimi në pronë - Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nga tatimi në pronë për vitin 2014 kishte planifikuar që të realizoj shumën prej 567,178€, ndërsa kishte arritur të inkasoj 547,728€ apo 97% e planit. Ishin faturuar 18,237 obligues tatimor me një ngarkesë prej 853,897€, nëse e krahasojmë me faturimin atëherë inkasimi del të jetë rreth 64%. Ne kemi testuar dhjetë mostra nga tatimi në pronë dhe nga kjo kemi vërejtur se borxhe për vitin 2014 për mostrat e përzgjedhura janë me vlerë prej 28,825€. Borxhet total i akumuluar deri në vitin 2014 për tatimin në pronë ishte 4,812,000€.

**Rreziku** Nuk ka konsistencë në mes planifikimit, faturimit dhe inkasimit të tatimit në pronë. Ekzistojnë kufizime në mundësitë për të filluar me projektet e reja të planifikuara..

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të iniciojë analizën që qëndrojnë prapa kësaj mos konsistencë në këtë proces të inkasimit. Kontrollat e përmirësuara duhet të implementohen për të siguruar që në të ardhmen, planifikimi, faturimi dhe inkasimi i tatimeve është analizuar mirë, si dhe të hartohet një plan konkret i cili do të përmirësonte shkallën e mbledhjes së të hyrave

#### Çështja 11- Lejet e ndërtimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Nga lejet e ndërtimit për vitin 2014 Komuna kishte planifikuar që të realizoj shumën 677,628€. Ndërsa kishte arritur të inkasoj 182,355€ apo rreth 27%. Ne nga kjo llogari kemi testuar 5 mostra. Sipas ligjit për ndërtim nr. 04/L-110 neni 21 paragrafi 3 ceket se nëse aplikuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore, atëherë organi kompetent e lëshon lejen e ndërtimit. Ne kemi identifikuar se në një rast është lëshuar leja e ndërtimit nga drejtoria e urbanizmit (për afarizëm shumë banesorë me kate B+P+10/11), mirëpo aplikuesi kishte paguar vetëm një pjesë të taksës për leje të ndërtimit.

**Rreziku** Lëshimi i lejes së ndërtimit pa i kryer të gjitha obligimet nga ana e aplikuesit rritë rrezikun se të hyrat nga kjo llogari nuk do realizohen.

**Rekomandimi 10** Kryetari duhet të vendosë kontrole më të mira për lëshim të lejes së ndërtimit duke siguruar që të kryhen të gjitha obligimet para se të lëshohet leje.

## 4.4 Shpenzimet

### 4.4.1 Prokurimi

#### Përshkrimi

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Kemi identifikuar raste kur nga projekti i aprovuar me buxhet ishin bërë shpenzime për qëllime të tjera, pa aprovimet e duhura për rialokim. Testet tona kanë identifikuar çështjet në vijim:

---

#### Çështja 12 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

**E gjetura** Numri i madh i prokurimeve të realizuara përmes procedurave me vlerë minimale është tregues i dobët i planifikimeve të prokurimit duke iu shmangur aplikimit të procedurave të hapura. Komuna gjatë vitit 2014 kishte lidhur 143 kontrata. Nga këto, 127 ishin kontrata me vlerë të vogël dhe minimale;

Te kontrata "Furnizim me pajisje të IT për kabinetin e informatikës në Gjimnazin Frank Bardhi", me vlerë 2,498€, fillimisht ishte kryer furnizimi me pajisje të IT, pastaj ishin zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ishte nënshkruar kontrata;

Te kontrata "Furnizim me material zyrtarë ne kemi testuar tetë pagesa me vlerë 7,794€, dhe kemi konstatuare se komuna ishte furnizuar me artikuj që nuk kanë qenë pjesë e kontratës në vlerë 3,120€;

Te kontrata kornizë "Furnizim me kompjuter" te pagesa në vlerë 5,320€, komuna ishte furnizuar me pajisje të IT në vlerë 1,840€ të cilat nuk kanë qenë pjesë e kontratës bazë;

Te kontrata "Transporti i nxënësve në relacionin Vaganicë - SHMU "Skënderbeu" me vlerë deri në 10,000€, mungonte deklarata mbi disponueshmërinë e fondeve, njoftimi për dhënie të kontratës nuk ishte dërguar në KRPP, po ashtu kjo kontratë nuk ekzistonte në raportin kontratave vjetore;



Sipas LPP neni 81 dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik, neni 55, autoriteti kontraktues duhet të përgatitë një plan për menaxhim të kontratës. Ne kemi identifikuar se për katër kontrata të nënshkruara, nuk është përgatitur ky plan;

Tek kontrata "Ndërtimi i kanalizimit në Fushë Ibër dhe Iliridë në vlerë 117,905€, nuk ishin respektuar kriteret e dosjes tenderit. Operatori fitues nuk kishte ofruar kontrata për punët e ngjashme të realizuara, nuk kishte ofruar sigurim të ekzekutimit për periudhë dymbëdhjetë mujore dhe nuk kishte ofruar dëshmi për pronësinë e mjeteve të punës;

Te kontrata Rekonstruimi i shtresës së asfaltit në rrugët "Ukshin Kovaçica, "Safet Boletini, dhe "Driton Veliu" me vlerë prej 72,567€, kriter obligativ në dosjen e tenderit ishte që operatori të ketë referenca për punë të kryera. Kompania fituese nuk kishte ofruar këto dëshmi. Po ashtu, sigurimi i ekzekutimit kërkohej që të jetë për periudhën një vjeçare, ndërsa kompania kishte ofruar sigurim me kohëzgjatje vetëm për një muaj;

Gjatë rishikimit të pagesave për investime kapitale kemi vërejtur se komuna kishte bërë klasifikim të shpenzimeve në kode të gabuara. Nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale kishte bërë pagesa për mallra dhe shërbime (pastrim të lumenjve, asgjësim i deponive të egra, dekorimi i qytetit për festa, mirëmbajtje e varrezave, etj). Vlera e këtyre pagesave është 132,288€;

Komuna kishte iniciuar procedurat e prokurimit dhe kishte nënshkruar kontrata në mungesë të fondeve të mjaftueshme si në rastet;

- Për kontratën "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fshatin Koshtovë" në vlerë 61,755€. Pjesa prej 30,000 € ishte zotuar para nënshkrimit të kontratës, ndërsa pjesa tjetër e projektit është zotuar pas nënshkrimit të kontratës.
- Për kontratën "Ndërtimi i rrugëve në fshatin Lushtë " në vlerë 56,752€, zotimi i mjeteve është bërë pas nënshkrimit të kontratës.

## **Rreziku**

Dështimi që procedurat e prokurimit dhe udhëzuesit përkatës të aplikohen me konsistencë, mund të rezultojë në mos realizim të kontratave dhe në kosto shtesë për komunën, në pagesa të gabuara dhe të parregullta dhe në vlerë të dobët për para.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të inicojë rishikimin e arsyeve që qëndrojnë prapa procedurave të dobëta të prokurimit në rastet si më sipër, dhe të zbatoj kontrole të forcuara të cilat sigurojnë se prokurimet e sigurojnë aftësinë e kontraktorëve për t'i përfunduar kontratat; se kërkesat administrative të tenderëve janë plotësuar, dhe se nuk do të aplikohet kuotimi i çmimeve, me përjashtim të rrethanave kur kjo është e domosdoshme. Po ashtu, kryetari duhet të sigurohet se keq klasifikimi i shpenzimeve do të rishikohet dhe dështimet e tilla nuk do të përsëriten në të ardhmen.

### Çështja 13 - Dobësitë jo sistematike të prokurimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Te kontrata "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fshatin Koshtovë" me vlerë 61,755€, komuna kishte paguar për punët shtesë shumën prej 5,245€ të cilat nuk kishin qenë të parapara më kontratë bazë. Për këto punë shtesë nuk ishte nënshkruar aneks kontratë, siç kërkohet me ligjin e prokurimit publik dhe nuk ishte dërguar formulari standard për njoftim në KRPP i nënshkruar nga ZKA dhe menaxheri i prokurimit;

Në një raste komuna kishte paguar shumën 4,659€ në emër të avansit për investime (15%). Pagesa ishte ekzekutuar nga kodi ekonomik rrugë lokale (31230), e jo nga kodi avans për investime(31910).

Te kontrata Asfaltimi i rrugës Muhamet Gashi me vlerë prej 14,970€, kemi identifikuar se ky projekt nuk kishte qenë i paraparë në PIP dhe plan të prokurimit. deklarata e nevojave mbi disponueshmërin e mjeteve nuk ishte dërguar në AQP së paku 5 ditë para se të fillojë inicimi i procedurave të prokurimit.

Te kontrata "Ndërtimi i Rrugëve në fshatin Lushtë " me vlerë 56,752€, kemi identifikuar se formimi i komisionit për vlerësim të tenderëve ishte me vonesë prej shtatë ditë. Sipas udhëzuesit operativ për prokurimin publik, procesi i vlerësimit të tenderit duhet të fillojë jo më vonë se 96 orë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

**Rreziku** Rastet e identifikuara më lartë tregojnë për kontrole të dobëta tek procesi i prokurimit dhe procesimi i pagesave. Punët shtesë pa aneks kontratë, rrisin rrezikun që komuna të paguaj çmime jo konkurruese në treg, ndërsa mos aplikimi i rregulloreve dhe të prokurimit, paraqesin pa pajtueshmëritë dhe jo efikasitetin e prokurimit.

**Rekomandimi 12** Kryetari duhet të sigurojë një analizë të arsyeve që qëndrojnë prapa mos ndjekjes së kërkesave për prokurim në rastet e identifikuara dhe të aplikoj kontrole të përmirësuara që të siguroj që dobësitë me kohë janë identifikuar dhe janë adresuar.



## 4.4.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

### Përshkrimi

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 10,372,660€ ndërsa shpenzimet për 2014 ishin 10,299,754€, apo 99%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave, b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Gjatë auditimit të Pagave dhe Mëditjeve, ne kemi rishikuar pranimin e punëtorëve të rinj në punë, largimin nga puna, pensionimin dhe kemi ngritur çështjet që janë paraqitur më poshtë:

---

### Çështja 14 - Pranimi i stafit të rinj jashtë planifikimeve buxhetore - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Drejtoria e arsimit kishte lidhur shtatë (7) kontrata me mësimdhënës të rinj gjatë vitit 2014. Ky numër i të punësuarve nuk ishte i planifikuar me buxhet dhe si rezultat i kësaj këta punëtor kanë mbetur jashtë listës së pagave. Ne kemi identifikuar se punëtorët të cilët udhëtojnë prej Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) nëpër QMF dhe Ambulanta të Mjekësisë Familjare (AMF), ju bëhet kompensimi i shpenzimeve të rrugës në bazë të vendimit nr. 63 të datës 08.03.2011 në lartësinë prej 50% të biletës së udhëtimit. Ne nuk kemi gjetur dëshmi (fatura/bileta) që konfirmojnë rregullsinë e këtij kompensimi.

Gjatë rishikimit të pagave në sektorin e shëndetësisë (QKMF), në dy mostra të testuara kemi vërejtur se orët e punës gjatë natës llogariten me 50% të pagës bazë ndërsa në bazë të ligjit të punës neni 56 pika 2.2 orët e natës duhet të llogariten me 30% të pagës bazë.

**Rreziku** Pranimi i stafit të ri në mungesë të buxhetit dhe mos përfshirja e tyre në listën e pagave rrite rrezikun e padive gjyqësore nga ana e punonjësve e cila mund të ndikoj në implikime buxhetore financiare, si dhe pagesat e pa dokumentuara në shëndetësi rritin rrezikun e pagesave jo korrekte.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet të sigurojë se vendosen kontrole të duhura për të parandaluar gabimet e identifikuar dhe të sigurojë se pranimi i stafit të ri të bëhet vetëm atëherë kur pagat janë planifikuar me buxhet.

### 4.4.3 Subvencionet dhe Transferet

#### Përshkrimi

Në vitin 2014 komuna ka bërë ndarjen e subvencioneve për entitete publike dhe jo publike. Nga kjo kategori kemi testuar pagesat dhe kemi rishikuar nëse këto janë bërë në përputhje me rregulloren e ndarjes të subvencioneve. Disa nga mangësitë janë prezantuar më poshtë:

---

#### Çështja 15 - Dhënia e Subvencioneve pa kriteret të caktuara dhe mungesa e monitorimit të subvencioneve nga Komuna - Prioritet i lartë

##### E gjetura

Në bazë të vendimit të kryetarit nr. 01/14489 dhe planit të punës së Zyrës komunale për komunitete dhe kthim është bërë subvencionimi i 105 përfituesve me pako ushqimore dhe higjienike në shumën 3,738€. Ne kemi vërejtur se nuk kishte ndonjë raport prej komisionit për mënyrën e përzgjedhjen e përfituesve dhe nuk dihet se në bazë të cilave kriteret është bërë përzgjedhja e tyre. Furnizimi ishte kryer nga kompania e kontraktuar, nuk kishte ndonjë raport nga komuna për monitorimin e tyre se si është bërë shpërndarja e tyre.

Drejtoria e mirëqenies sociale ka subvencionuar 78 familje raste sociale me pako ushqimore në shumën 3,540€. Furnizimi me pako ushqimore nga familjet përfituese ishte bërë nga kompania e kontraktuar. Komuna nuk kishte monitorim formal.

Me datë 25.06.2014 Kryetari i Komunës kishte marr vendim për ndarjen e mjeteve prej 1,353€ si subvencion për përkrahjen financiare për realizimin e projektit Këshilli i veprimit rinor lokal (KVRL). Qëllimi i këtij projekti është rritja e vetëdijes së të rinjëve për pjesëmarrjen në vendimmarrje si dhe ngritja e kapaciteteve rinore nëpër organizatat e ndryshme jo qeveritare. Nuk ka dëshmi që janë mbajtur ligjërata nëpër shkolla, mungon hartimi i projekteve ashtu siç ishte paraparë me projekt. Nga dëshmitë e ofruara shihet se rreth 50% e këtij subvencioni ishin shpenzuar për ushqim dhe pije e jo për qëllimin e dhënë.

Në bazë të vendimit të kuvendit të datës 27.03.2014 është bërë subvencionimi i Organizata Joqeveritare (OJQ) "Valët e Paqes" (5,000€) për projektin avancimi i pozitës së të rinjve. Raportet pas përfundimit të projektit nga OJQ nuk dëshmojnë për mënyrën e përzgjedhjes së personelit trajnues dhe ligjërues si dhe pjesëmarrësve të cilët kanë ndjekur trajnimet. Nuk është ofruar siguri se përfitues nga këto aktivitete janë kategoritë të cilat kanë më shumë nevojë për përkrahje. Në pagesat në formë të parave të gatshme janë përfshirë edhe pagesa për vullnetarët e angazhuar në projekt.

Në bazë të vendimit të kryetarit të komunës të datës 23.12.2011 për ndarjen e pakove ushqimore për stafin e Departamentit për Kulturë Rini dhe Sport (DKRS) me rastin e festës së vitit të ri, është ekzekutuar pagesa me vlerë prej 3,000€. Nëpunësit e komunës nuk duhet të përfitojnë nga kategoria e subvencioneve.

OJQ "Mundësia" është subvencionuar në bazë të vendimit të Kuvendit komunal të datës 30.10.2014 në vlerë prej 19,700€, për blerjen e një mamografi digjital për Mitrovicën. Këto mjete me datën 02.12.2014 ishin transferuar në llogarinë e OJQ-së. Komuna nuk kishte lidhur marrëveshje me OJQ-në për të treguar se kush do të menaxhojë me pajisjen si dhe për mënyrën e raportimit për fondet e shpenzuara. OJQ "Mundësia" kishte dërguar një shkresë komunës që tregon se këto fonde nuk janë të mjaftueshme për të blerë mamogarin dhe se janë duke bërë përpjekje për sigurimin e pjesës së fondeve të nevojshme për këtë blerje.

#### **Rreziku**

Mos vendosja e kriterëve paraprake për subvencione dhe monitorimi i dobët nga ana e komunës, rritë rrezikun që subvencionet e dhëna të mos arrijnë objektivat apo qëllimin e duhur.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur kriteret për ndarjen e subvencioneve dhe monitorim të vazhdueshëm për të gjitha subvencionet për të siguruar se këto subvencione arrijnë qëllimet.

## 4.5 Pasuritë dhe detyrimet

### 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrim

Komuna me datën 10.09.2014 ka formuar një komision për vlerësimin e pasurisë jo financiare. Ky komision është në proces të vlerësimit të pasurive.

---

#### Çështja 16 – Dobësi në menaxhimin e pasurive – Prioritet i lartë

**E gjetura** Komuna nuk ka procedura të brendshme të shkruara për menaxhimin e pasurive, ashtu siç kërkohet. pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në kategorinë e investimeve në vijim, mirëpo gjatë vitit, nga komuna nuk kishte regjistruar asgjë në këtë kategori.

Duke u bazuar në regjistrin që kemi siguruar në Drejtorinë e urbanizimit për pronat e dhëna më qira, aty janë identifikuar toka banesa dhe lokale që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të pasurive.

Komuna duhet të posedojë informata se çfarë pasurie ka në përdorim secili zyrtar. Komuna në regjistrat e saj të pasurive posedon të dhëna për pasurinë që ngarkohet secila drejtori, e jo të dhëna për zyrtar individual.

Sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë kërkohet që zyrtari pranues të regjistrojë të gjitha pasuritë dhe stoqet më vlerë nën 1,000€ në softuerin e pasuria. Ne kemi vërejtur se deri më tani nuk janë regjistruar pasuritë me vlerën nën 1,000€ në këtë softueri.

**Rreziku** Mungesa e kontrolleve në mirëmbajtjen e regjistrit kontabël dhe mos regjistrimi i pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhim të pasurive, mund të shpie në humbjen, keqpërdorimin dhe përdorimin e paautorizuar të pasurisë publike.

**Rekomandimi 15** Kryetari duhet të sigurojë hartimin e një udhëzuesi të brendshëm për menaxhim të pasurive ku qartësohen rolet dhe detyrat e zyrtarëve të caktuar të cilët duhet të kontribuojnë në përgatitjen e të dhënave për pasurinë që duhet regjistruar.

## 4.5.2 Trajtimi i borxheve

### Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve për vitin 2014 ishte 667,000€. Krahasuar me vitin 2013, ku shuma e obligimeve ishte 972,000€, komuna ka arritur që t'i zvogëloj obligimet e papaguara për rreth 300,000€.

---

### Çështja 17 - Mos pagesa e faturave sipas afatit ligjor - Prioritet i lartë

**E gjetura** Ekziston një shumë e konsiderueshme e detyrimeve të papaguara të bartura për vitin 2015. Ne kemi testuar 13 fatura të papaguara që janë raportuar si borxhe në Ministrinë e Financave dhe kemi konstatuar se komuna nuk i ka kryer obligimet brenda afatit të paraparë prej 30 ditë. Po ashtu, komuna kishte prezantuar gabimisht si obligim të papaguar shumën prej 16,500€,

**Rreziku** Mos pagesa me kohë e obligimeve të komunës rrit rrezikun që pagesat të bëhen në mënyrë të detyrueshme nga Thesari dhe të rritet numri i padive gjyqësore. Bartja e obligimeve për pagesë në vitin tjetër, ndikon që objektivat e vitit vijues të mos arrihen.

**Rekomandimi 16** Kryetari duhet të iniciojë një analizë të arsyeve që qëndrojnë prapa një shumë kaq e madhe e obligimeve për të siguruar se të gjitha faturat do të paguhen brenda afateve ligjore..

## 4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

### Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) funksionon me staf prej tre anëtarëve. Një NjAB efektive zbaton një program gjithë përfshirës pune i cili pasqyron rreziqet financiare dhe rreziqe të tjera të Komunës dhe ofron siguri të mjaftueshme për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme. Ndikimi i rezultateve të NjAB duhet të gjykohet bazuar në rëndësinë që menaxhmenti i jep adresimit të rekomandimeve, sfidave si dhe mbështetjes që ofrohet nga një Komitet efektiv i Auditimit.

NJAB-i për vitin 2014 kishte planifikuar dhe kryer pesë auditime dhe kishte arritur që t'i përfundojë të gjitha sipas planit. Fushat e audituara ishin: (a) Rekrutimi, (b) Shpenzimet kapitale, (c) Menaxhimi i pasurisë, (d) Të hyrat vetjake dhe (e) Prokurimi.

Po ashtu, NJAB-i kishte përgatitë raporte tre mujore, të cilat i kishte dërguar edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese në Ministri të Financave.

NJAB e kishte përgatitë planin vjetorë dhe kishte përfshirë fushat me rrezik të lartë, por më shumë ishte fokusuar në aktivitetet e vitit paraprakë dhe jo në vitin aktual.

Komuna ka të formuar komitetin e auditimit i cili gjatë vitit 2014 ka mbajtur pesë takime të rregullta, ku janë shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm dhe puna e kësaj njësie. Nevojitet një punë më cilësore dhe më e theksuar e komitetit në drejtim të shtyrjes së implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, nga ana e menaxhmentit të komunës.

---

### Çështja 18 – Fokusimi i rishikimit gjatë vitit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Fokus i rishikimeve të auditimit të brendshëm gjatë vitit 2014 në të shumtën e rasteve ishin aktivitetet e vitit 2013, dhe ne mendojmë se kjo pak i shton vlerë përmirësimit të kontrolleve aktuale. Ne kemi identifikuar se menaxhmenti i komunës kishte ndërmarr disa veprime për të adresuar rekomandimet e auditimit të brendshëm, por rëndësia dhe roli i auditimit të brendshëm ka nevojë të forcohet edhe më tutje.

**Rreziku** Mungesa e fokusit të auditimit të brendshëm dhe mos adresimi i rekomandimeve mund të rezultojë me mos identifikim dhe adresim të dobësive aktuale të kontrollit, që do të kishte si pasojë mos-efikasitetet operacional dhe humbje financiare për komunën.

**Rekomandimi 17** Kryetari duhet të sigurojë funksionim të plotë të Sistemit të Auditimit të Brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të forcojë punën e vet. NjAB duhet të zhvillojë qasjen e bazuar në rrezik si bazë për planifikimin e auditimit. Rekomandimet duhet të adresohen si duhet.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.



Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.



158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Mungesa e dëshmive për pagesat nga palët e treta që janë prezantuar në PVF.	Kryetarin i Komunës të siguroj se do të identifikohen të gjitha pagesat nga palët e treta që janë bërë në Komunën e Mitrovicës dhe këto të mbështeten me dokumentet burimore në mënyrë që të prezantohen drejt në PVF-të.		Pjesërisht	
1.1 Mungesa e regjistrimit të pasurive që janë në pronësi	Kryetari duhet të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014.		Pjesërisht	
1.2 Procesi i përgatitjes së pasqyrave	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF të vitit 2014 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat e që kanë të bëjnë me cilësinë e informatave. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet me pohime të tilla, përveç nëse në të gjitha draft PVF janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Po		
2. Rekomandimet e vitit paraprakë	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Pjesërisht	

3. Qeverisja e mirë	Kryetari i Komunës duhet të kryejë një rishikim të formës së raportimit tek menaxhmenti i lartë, për të përcaktuar çka kërkohet për të mbështetur menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të paraqesë një zgjidhje të përshtatshme deri më 1 shtator 2014.		Pjesërisht	
3.1 Ekzekutimi i buxhetit	Kryetari i Komunës duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore, sidomos te kategoria e investimeve kapitale dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			Jo
4. Tatimi në pronë	Kryetari i Komunës duhet të rishikoj politikat aktuale dhe të ndërmarrë masat dhe veprimet konkrete për mbledhjen e këtyre borxheve, duke mos përjashtuar edhe masat administrative dhe gjyqësore.		Pjesërisht	
4.1 Lejet e ndërtimit	Kryetari i Komunës duhet që të siguroj se do merren masa që mos të ketë ndërtime pa leje dhe pasi që të nxirren vendimet për rrënimin e objekteve, të njëjtat të ekzekutohen deri në finalizim nga organet përkatëse.	PO		
4.2 Të hyrat nga dhënia e pronës me qira	Kryetari i Komunës duhet t'i rishikoj të gjitha kontratat ekzistuese për dhënie me qira të tokës, lokaleve dhe banesave dhe të identifikoj arsyet pse nuk po kryhen obligimet. Duhet të ndërmerren masa me kohë nga menaxhmenti që qiramarrësit t'i kryejnë obligimet në çdo muaj sipas kontratës.		Pjesërisht	

4.3 Taksa për veprimtari biznes ore	Kryetari i Komunës duhet t'i rishikoj të gjitha kontratat ekzistuese për dhënien me qira të tokës, lokaleve dhe banesave dhe të identifikoj arsyet pse nuk po kryhen obligimet. Duhet të ndërmerren masa me kohë nga menaxhmenti që qiramarrësit t'i kryejnë obligimet në çdo muaj sipas kontratës.		Pjesërisht	
5. Prokurimi- klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet të bëhen sipas natyrës përkatëse në përputhje me kërkesat e LMFPP-së dhe Ligjit të Buxhetit.			Jo
5.1 Mosrespektimi i kritereve të vendosura në dosjen e tenderit	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se në të gjitha rastet e prokurimit, vlerësimi i ofertave bëhet në mënyrë objektive dhe të respektohen të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit.			Jo
5.2 Mungesa e raporteve me rastin e angazhimit të punëtorëve me kontrata për marrëveshjet e veçanta	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se kontratat me marrëveshje të veçanta të përdoren për qëllimin e përcaktuar dhe se punëtorët e kontraktuar në këtë mënyrë raportojnë për punën e bërë.	Po		
5.3 Ndarja e tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura të prokurimit	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se gjatë kërkesave për furnizime, fillimisht të bëhet një planifikim i mirë sipas nevojave reale, në mënyrë që mos të ketë ndarje të tenderëve për t'iu shmangur procedurave të hapura të prokurimit.			Jo
5.4 Pagesa për material ndërtimor	Kryetari i Komunës duhet të inicioj këtë çështje tek organet mbikëqyrëse të projektit dhe të sigurohet se sasia e lejuar e materialeve ndërtimore ka arritur tek përfituesit e fundit. Në të kundërtën, duhet të pasojnë masat e llogaridhënies se çfarë ka ndodhur me sasi të e faturuara, por të pa dorëzuara tek përfituesit.	Po		

5.5 Përfshirja e pozicionit të njëjtte në dy kontrata të ndryshme	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do të forcoj kontrollet me rastin e çertifikimit të pagesave, në mënyrë që mos të bëhen pagesa të parregullta/ të dyfishta.	Po		
6. Kompensimet	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se janë respektuar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe emërimit në përputhje me ligjin për Shërbimin Civil dhe rregulloret në fuqi. Gjithashtu, duhen të vendosen kontrole të shtuara për të parandaluar gabimet e shumta të identifikuara gjatë procesimit të pagesave. Pagesat e bëra më tepër, duhet t'i kthehen buxhetit të komunës.		Pjesërisht	
7. Subvencionet dhe transferet - Dhënia e subvencionit pa aprovim të Kuvendit Komunal dhe në mungesë të marrëveshjeve	Kryetari i Komunës duhet të siguroj që të respektohet rregullorja e brendshme e subvencioneve dhe të bëhen marrëveshje me përfituesit duke i obliguar për mënyrën e shpenzimit dhe raportimit në mënyrë që të sigurohet që subvencionet kanë arritur objektivat.		Pjesërisht	
7.1 Subvencionet janë shpenzuar për Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere duhet të shpenzohen vetëm në këto fusha, në mënyrë që të arrihen objektivat dhe shpenzimet të behën në pajtim me kërkesat ligjore.		Pjesërisht	
7.2 Dhënia e subvencioneve pa kriteret e caktuara	Kryetari i Komunës duhet të siguroj që të vendosen kriteret për përfituesin nga një komision i formuar nga komuna, dhe të respektohen kriteret e vendosura.			Jo
8. Pasuritë kapitale dhe jo kapitale - Mungesa e regjistrimit të plotë të pasurive dhe mos pajtueshmëri me rregulloren për pasuri	Kryetari i Komunës duhet të siguroj formimin e një komisioni profesional për pasuri dhe ato të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.		Pjesërisht	

8.1 Regjistrimi i jo i saktë i pasurisë	Kryetari i Komunës duhet të siguroj që të ketë nivele me të larta të kontrollit lidhur me regjistrimin e pasurisë ne SIMFK. Ky regjistër duhet që të rishikohet dhe të korrigojohet.	Po		
9. Trajtimi i borxheve	Kryetari i Komunës duhet të harmonizoj ndarjet buxhetore me hyrjen në obligime dhe të sigurohet se të gjitha obligimet mbahen nën kontroll dhe shoqërohen me fondet përkatëse buxhetore.	Po		
10. Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të diskutoj me auditimin e brendshëm mbi mangësitë e kontrolleve dhe rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NJAB, dhe në bazë të kësaj, të nxjerrë një Plan veprimi duke urdhëruar Drejtoritë përkatëse zbatimin e rekomandimeve të dala nga auditimi i brendshëm.		Pjesërisht	